



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIATI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Nr 47 Prot.

Vlorë, më 17 . 10 . 2018

VENDIM

Nr. 14 _ Data 10.10.2018 _

Për miratim në parim të kërkesës, për shfrytëzim të burimit uhor Lumi i Zhulatit, dega e lumit Kardhiq, dega e lumit Vjosë, për ndërtimin e hidrocentralit "Zhulat" për prodhim të energjisë elektrike, Fshati Zhulat, Bashkia Gjirokastrë, Qarku Gjirokastrë, subjektit "DEA HYDROPOWER" sh.p.k., me administrator Z. Gentian Priftaj.

Në bazë të ligjit **Nr.111/2012 datë 15.11.2012** "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", ligjit nr 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 111/2012 " Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" të **V.K.M 416 datë 13.05.2015** "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", , Vendimit **Nr. 876, datë 14.12.2016** "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit **Nr. 662 datë 21.09.2016** "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta ", Vendimit **Nr.5 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Uhor", Vendimit **Nr.6 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjensisë së Basenit Uhor"; V.K.M Nr.822, datë 07.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni",

VENDOSI

Miratim në parim të kërkesës, për shfrytëzim të burimit uhor Lumi i Zhulatit, dega e lumit Kardhiq, dega e lumit Vjosë, për ndërtimin e hidrocentralit "Zhulat" për prodhim të energjisë elektrike, Fshati Zhulat, Bashkia Gjirokastrë, Qarku Gjirokastrë, subjektit "DEA HYDROPOWER" sh.p.k., me administrator Z. Gentian Priftaj me këto të dhëna:

Koordinatat KRGJSH: X 496136; Y 4443654; Z 442

Prurja mesatare: 2.1 m3/sek

Prurja e llogaritur: 3.000 m3/sek

Prurja e ekologjike: 0.098 m3/sek



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIATI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Godina e centralit X 498125 Y 4443049 Z 360

Fuqia e instaluar e hidrocentrali llogaritet të jetë 1850 *kW*

Për përdorimin e këtij burimi ujor duhen të plotësohen me përpikmëri kushtet e lejes.

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËS I A.B.U "VJOSË"

Ilir PROFKA

KRYETAR I K.B.U "VJOSË"

Flamur MAMAJ